



REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIKA KOSOVA
 REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
 OPŠTINA LIPLJAN
 MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 11-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 28.09.2022, në sallën e Kuvendit, me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezantuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Nexhmedin Lekiqi, anëtar
3. Shefki Bytyqi, anëtar
4. Gazmend Qerkini, anëtar
5. Shkelzim Olluri, anëtar
6. Albiona Tasholli, anëtare
7. Fadil Sopa, anëtar
8. Xhyla Dedushaj-Rexhepi, anëtare
9. Sami Bytyqi, anëtar
10. Fitim Shala, anëtar
11. Xhyzide Rustemi, anëtare
12. Rinor Murati, anëtar
13. Armend Grajqevci, anëtar
14. Majlinda Sylejmani, anëtare
15. Gentianë Hoxhaj, anëtare
16. Venhar Agushi, anëtar
17. Lulzim Rustemi, anëtar
18. Herolind Kozhani, anëtar
19. Ardit Cani, anëtar
20. Arsim Jashari, anëtar
21. Egzona Bytyqi, anëtare
22. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
23. Ganimete Qeriqi, anëtare
24. Alban Salihu, anëtar
25. Fitim Meziu, anëtar
26. Fadil Spahiu, anëtar
27. Fatmir Fetahu, anëtar
28. Shahadije Dragacina, anëtare
29. Besiana Sylja, anëtare
30. Enver Kryeziu, anëtar
31. Bashkim Budakova, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Lulzim Qerimi, Nënkyetar i Komunës
3. Latif Ramadani DBF
4. Anila Reçica, DKRS
5. Valon Pacolli, DEZH
6. Shkelzen Hajdini, DSH
7. Flamur Sylejamni, DI
8. Elmaze Behluli, DA
9. Sead Aliu, DI
10. Rexhep Rexhepi, DBP
11. Rasim Hasani, DA
12. Safete Amerllahu, DGJK
13. Përfaqësues të medieve dhe shoqërisë civile dhe të tjerë prezentë

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pasi që i përshëndeti të pranishmit tha rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës të propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 10-të e Kuvendit.
2. Propozim Vendim mbi Rialokimin e mjeteve të buxhetit për vitin 2022.
3. Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit të Komunës për vitin 2023-2025.
4. Propozim Vendim mbi aprovimin e buxhetit për vitet 2023-2025.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit për periudhën 3 Korrik 2021 – 3 Korrik 2022.
6. Propozim Vendim për miratimin e programit trevjeçar për banim 2022-2025 të Komunës së Lipjanit.
7. Propozim Vendim mbi caktimin e tarifave për qëndrimin ditor të fëmijëve në institucionet parashkollore në fshatrat Gadime dhe Sllovi.
8. Propozim Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.
9. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB-së.
10. Raporti gjashtëmujor, Janar-Qershor 2022, i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.
11. Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve në ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi".

12. Propozim Vendim për përcaktimin e destinimit dhe ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga shkolla fillore Banullë në Komuna e Lipjanit.

13. Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për trajtimin qenve endacak në territorin e Komunës së Lipjanit.

14. Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarët të komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

Pastaj Kryesuesi pyeti se a ka vërejtje apo plotësime rreth rendit të ditës?

Meqë vërejtje as plotësime nuk pati, Kryesuesi vuri në votim rendin e ditës të propozuar dhe pas votimit u konstatua se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi rendin e ditës..

Pastaj u kalua në Pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Ganimete Qeriqi, tha se kam një kërkesë nga kolegët e shëndetësisë që të ketë një byfe që të ushqehet personeli shëndetësor, po ashtu do të punësoheshin edhe njerëz në atë byfe.

Besiana Syla, tha se unë kam për t'i ngritur disa çështje, e para në muajin gusht është mbajtur një tryezë diskutimi nga organizata Polis me temë Avokimi për buxhetim të shërbimeve sociale për vitin 2023, ku kishte të pranishëm nga OJQ-të nga ekzekutivi dhe përfaqësues të qytetarëve. Dhe aty është diskutuar për shërbimet sociale, dhe unë dua ta dijë se çfarë interesimi ka shfaq komuna për këto kategori, dhe a është hartuar ndonjë projekt nga komuna për këto kategori. E dyta ka të bëjë me banorët e fshatit Lugaxhi të cilët po përballen me rrjetin e ujësjellësit dhe kanalizimit, me këtë gjendje përballen ata banorë qe 10 vite.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, tha kërkoj nga ana juaj anëtarë të Kuvendit që të respektoni rregulloren e punës duke bërë pyetje siç ju takon me rregullore të punës, vetëm 2 minuta, por jo diskutime.

Arsim Jashari, tha se pyetja e parë kur pritet që të transmetohet live mbledhja e kuvendit. Kam një kërkesë të disa banorëve që të vendosen pengesat në rrugën Mihail Pupin pasi që po vozisin me shpejtësi të madhe në atë rrugë. Një kërkesë tjetër e banorëve të Janjevës, lagjen "Dardania" rruga, "Nëna Terezë" e cila është në gjendje të mjerueshme, te paktën nëse ka mundësi të zhavorrohet. Dhe e fundit janë shqetësuese punësimet e fundit në baza partiake, ku po demoralizohen të rinjtë çdo ditë e më shumë me punësimet familjare e partiake, me këtë po e humbin shpresën qytetarët e komunës së Lipjanit. Ne si anëtarë të Kuvendit kërkojmë që të bëhet depolitizimi i institucioneve.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit, tha se sa i përket transmetimit të mbledhjeve live, jemi duke pritur që të dalim në komunën e re, por edhe këtu po kemi

problem me rrjetin qeveritar. Po shpresojmë që shumë shpejtë do të dalim në komunën e re.

Ardit Cani, tha se e kam një kërkesë për drejtorinë e shërbimeve publike për vendosjen e disa shenjave në rrugë për ndalimin e qarkullimit të kamionëve me pesha të rënda të cilët po kalojnë në rrugën nëpër Baincë, dhe Shalë, po ashtu kërkoj edhe nga drejtoria e inspektionit të ndërmarrë masa ndaj këtyre . Po ashtu kërkoj që të bëhet rregullimi i trotuarit në fshatin Baincë.

Fitim Mëziu, tha se unë si anëtar i kuvendit nga sot zyrtarisht do të jem i pavarur dhe do të përfaqësoj interesat e qytetarëve si i pavarur dhe nuk do ti përkas asnjë grupi politik në kuvend. Kam një kërkesë nga qytetarët për Lagjen e Re ku ka një defekt në kanalizim ku ujërat e zeza dalin në pjesën fushore. Kërkojnë qytetarët që të ndermirren masa për këtë rrugë.

Shahadije Dragaçina, tha se unë kam për ta ngritur një çështje që ka të bëjë me objektin e QKMF-së në Lipjan.Gjatë vizitës atje e kam parë aty një hapësirë jo funksionale. Pyetja është për drejtoratin e shëndetësisë pse ka mbetur në atë gjendje në katin e parë a është duke u kryer ndonjë renovim në atë pjesë. Çështja e dytë ka të bëjë në mos realizimin e kërkesave të qytetarëve edhe pse na disa herë i kemi ngritur ato, po ashtu edhe kanë ardhur direkt nga qytetarët.

Fadil Spahiu, tha se edhe unë ju njoftoj se nga sot nuk do të jem pjesë e LVV-së në kuvend por do ti përfaqësoj interesat e qytetarëve si anëtarë i pavarur i kuvendit. Kam një kërkesë për drejtoratin e shëndetësisë,qe të jetë edhe një dhomë shtesë për marrje të infuzioneve pasi që është numri i lartë i pacientëve që shkojnë aty?

Egzona Bytyqi,i kam dy çështje, e para ka përfundua konkursi për zonën ekonomike në Qylagë, deri më sot sa biznese kanë aplikuar dhe sa jeni të kënaqur ju si ekzekutiv në këtë aspekt? E dyta ka të bëjë me ndërtesat kolektive në Magurë të cilat përveç që i'a kanë humb imazhin asaj pjese, po ashtu po janë të rrezikshme për qytetarët e asaj pjese.

Lulzim Rustemi, tha se i kam disa kërkesa të qytetarëve,e para ka të bëjë me lapidarin në Kraishtë ku ka pësuar disa dëmtime po ashtu i ka edhe disa gabime teknike prandaj do të ishte mirë me intervenua aty me rregulluar atë lapidar. Në rrugën Lipjan-Konjuh, ndriçimi nuk po funksionon. Është mirë që nëpër shkolla mos të ketë iniciativa të prindërve për renovimin e bankave dhe korrigave të shkollave,pasi që ka mjete nga drejtoritë pavarësisht vullnetit të qytetarëve. Dhe e fundit sa i përket konkurseve në arsim ka vërejtje se nuk ka profesionalizëm në punësim.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se po me vjen mirë që sot, në rend të ditës është trajtimi i qenëve endacak,pasi çdo ditë e më shumë po jemi të rrezikuar nga qentë

endacak. Çështja e dytë ka të bëjë me ujin e pijshëm ku ka disa fshatra si prsh Sllovia që vetëm 1 orë në ditë kanë pas ujë të pijes brenda 24 orëve. Në disa fshatra po ka deponi te mbeturinave e ku edhe po i ndezin qytetarët dhe për këtë duhet të jetë me aktiv drejtorati i inspektionit. Për punën që është bërë në rrugën “Zylfie Gashi” e përgëzoj komunën, mirëpo ndriçimi publik nuk po funksionon?

Alban Salihu,tha se në emër të LVV-së, ju kërkoj asamblesitëve Fitim Mëziut dhe Fadil Spahiut ta dërzojnë mandatin të cilët e kanë fituar në emër dhe program të LVV-së. Pyetje për kryetarin e komunës, vendimi për lirim nga tarafit e çerdhes a është përzirje në kompetenca të Kuvendit? Pyetje për Drejtorin për Ekonomi dhe Zhvillim, sa është numri i bizneseve që kanë aplikuar në zonën ekonomike në Qylagë. Pyetje për drejtorinë e kulturës rreth stadiumeve në Magurë Dobrajë, a keni ndonjë plan pasi që siç shihet nuk është që janë nda shumë mjete nga buxheti për këto.

Fitim Mëziu tha,se unë kam marrë vota në listën e LVV-së,duke qeni i fundit në listë me numër rendor 34 dhe kam dalë më i votuari. Unë do t'i barti kërkesat e qytetarëve të cilët pa dallime politike me kanë votuar,por si anëtar i pavarur i Kuvendit

Fadil Spahiu, tha se unë i kam marr votat nga qytetarët dhe do të i përfaqësoj qytetarët si anëtar i pavarur i Kuvendit. Po të isha bartës i listës do ta dërzoja mandatin , por unë e ftoj Albanin që ta dërzojmë të dy së bashku mandatin.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se,rruga “Zylfije Gashi” është projekt 2 vjeçar e ku përfshihet edhe ndriçimi publik së bashku me rrugën “Isa Olluri”. Pat disa kërkesa për pengesa në rrugë, nuk e kemi pas në kontratë por do ta parashohim në kontratat e ardhme pasi që po shihet që janë të nevojshme. Donacionet në shkolla vështirë me i ndal edhe pse unë jam kundër me pas vetiniciativa për investime të tilla pasi që komuna ka kapacitet për t'i kryer këto vet. Rruga rreth lumit Janjevka ka defekte, por ajo rrugë do ta ketë edhe një shtresë asfalt dhe ndriçimin publik. Te lapidari në Kraishtë nuk e dijë, pasi që ne nuk e kemi bërë atë. Uji rryma, ne nuk menaxhojmë me to, edhe pse na kemi investuar në ujë. Zona ekonomike jemi në përfundim të punës së komisionit, nuk jam i kënaqur me atë që është bërë atje, por shumë shpejt do të njoftoheni në kuvend me aplikantët. Ndërtesat në Magurë, janë pronë e AKP-së. Neve nuk po na lejojnë me i demolua ato,edhe pse ato janë në gjendje të keqe dhe po paraqesin rrezik ato. Po presim apo na jep leje AKP-ja, që me pastruar atë pronë. Ujërat e zeza në lagjen te Suhadolli, aty në atë pjesë kemi probleme pronësore, por ajo zonë është me Graqanicë por ne kemi aplikuar edhe në Ministri. Të njëjtën situatë e kemi edhe te QMI-ja, por ajo pjesë është me Graqanicë. Trotuar kemi nevojë ne disa vende por po kemi pengesa nga banorët për shkak të pronave private. Te punësimet nuk jemi ideal, por nganjëherë mund të ketë edhe gabime. Në Janjevë në atë rrugë, jetojnë 5 familje dhe të gjitha kërkojnë nga një urë,

për atë ka mbet ajo rrugë ashtu. Ju kisha lut të i dalloni cilat janë kompetencat e komunës e cilat të Ministrisë.

Arsim Jashari, tha se ajo rrugë në Janjevë është diku tjetër e jo ajo të cilën e tha kryetari. Ajo rrugë është në lagjen Dardania. Sot është dashtë kryetari i komunës me na e prezantuar drejtorin e Shërbimeve Publike. Edhe seancat live të Kuvendit duhet me i qit që me i pa qytetarët të përfaqësuesit e tyre.

Daut Azemi, tha se live nuk del mbledhja e Kuvendit, por del si audioingjizim të cilën mund ta shohin qytetarët.

Pasi që çështje tjera nuk pati u kalua me punë sipas pikës së parë të rendit të ditës.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 10-të e Kuvendit.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktet të cilat i keni marrë.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Pastaj Kryesuesi vuri në votim ekstraktet nga mbledhja e 10 e Kuvendit, , pas votimit konstatoi se Kuvendi me, 29 vota për aprovoi

Ekstraktit nga mbledhja 10-të e Kuvendit.

Shtesë: Ekstrakti

II.

Propozim Vendim mbi Rialokimin e mjeteve të buxhetit për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i'a dha fjalën, Latif Ramadani, DBF,i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne si grup i asamblesë i PDK-së, kemi një propozim që në rialokim të përfshihet renovimi i lapidarit në Kraishtë.

Latif Ramadani, tha se kërkesë e drejtë, por nuk besoj që do të kaloj kjo pikë në ministri por do ta shohim me ndonjë donacion apo me ndonjë mënyre tjetër ta përfshijmë atë.

Lulzim Rrustemi, tha se do të ishte mirë që kjo të hyj brenda projektit nëse ka mundësi, nëse jo tani të hyj prapë me mallra dhe shërbime.

Latif Ramadani, shuma që është e ndarë është jo e mjaftueshme për atë, por me ndonjë kod tjetër me mallra dhe shërbime ose me ndonjë tjetër ta parashohim.

Meqë diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi e vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për prezentë, 9 abstenime aprovoi vendimin.

Pastaj u kalua në pikën në vazhdim.

III

Raporti nga procesi i organizimit të dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit të Komunës për vitin 2023-2025.

Lidhur me këtë pikë kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i'a dha fjalën, Latif Ramadani, DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi, hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se dëgjimet buxhetore bëhen sa për sy e faqe, unë kam marrë pjesë në disa dëgjime buxhetore nëpër fshatra dhe e kam pa që interesimi i qytetarëve është i vogël e zakonisht marrin pjesë zyrtarët komunal. Pse mos ky interesim i qytetarëve, a është arsyeja e pare se qytetarët e kanë humb besimin në ekzekutivin, ndërsa arsyeja e dytë, se qytetarët nuk po njoftohen me kohë.

Arsim Jashari, tha se në aspektin procedural është në rregull, por nëse e bëjmë një analizë për marrjen pjesë të qytetarëve në dëgjime buxhetore i bjen që më pak se 1% e qytetarëve kanë marrë pjesë në dëgjime buxhetore. Unë jam ndër ta që kam marrë ftesë pasi që kemi pranuar ftesat për dëgjime publike. Dhe marrja pjesë kaq e vogël e qytetarëve është shqetësuese dhe për këtë duhet angazhimi i të gjithëve.

Bashkim Budakova, tha se është shqetësuese pjesëmarrja e qytetarëve në dëgjime buxhetore, që i bie me pak se 1% .Në të ardhem duhet të punohen më shumë në këtë drejtim dhe të gjendet arsyeja pse nuk po marrin pjesë qytetarët në dëgjime publike.

Lulzim Rrustemi, tha se raporti është në bazë të kornizave ligjore edhe është paraqitë ashtu si është saktë është transparent,por është obligim edhe i yni si anëtarë të Kuvendit që të marrim pjesë në dëgjime buxhetore pasi që ne i përfaqësojmë qytetarët. Ne kemi stagnuar edhe në zgjidhjen e këshillave të fshatrave dhe kjo ka ndikuar pak.

Latif Ramadani, tha se ne i kemi organizuar dëgjetimet buxhetore si drejtorat, por edhe kryesuesi se bashku me sektorin e Kuvendit i ka organizuar 2 dëgjime buxhetore, dhe ftesat dhe njoftimet janë dërguar me kohë.

IV

Propozim Vendim mbi aprovimin e buxhetit për vitet 2023-2025.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Latif Ramadani drejtor i DBF i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj Kryesuesi, hapi diskutimin?

Arsim Jashari,në KPF e kam ngritë punën e kontratës kolektive, dhe na kemi shumë padi në gjykatë e kjo e ka ngulfatë buxhetin e komunës. Shkolla e vjetër në Banullë është dashtë me hy në buxhet pasi ajo mund të dëmtohet shumë shpejtë, është mirë që të intervenohet sa me shpejtë në atë shkollë.

Besiana Syla, tha se te shërbimet sociale janë nda vetëm 10 mijë euro ndërsa në administratë më shumë, mos do të ishte mirë që mjetet që janë nda në administratë të barten te shërbimet sociale. Pres një sqarim pse janë nda 6 mijë euro për administratë komunale.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se nëse e krahasojmë këtë buxhet me premtimet e fushatës, nuk është askund, siç është premtimi, për shkollë në qytet po ashtu renovimi i QKMF-së në Shalë dhe Janjevë. Po ashtu objekti për personat me nevoja të veçanta,është hiç, nuk e di pse, do të ishte mirë me u rikthye. Po ashtu edhe stadiumi i futbollit në Gadime. Po ashtu duhet të bëhet shtatore të veçanti dëshmore të vetme femër Zylfije Gashit.

Alban Salihu, tha se një buxhet i planifikuar dobët shumë herë jo i specifikuar,pavarësisht që kemi marrë pjesë në dëgjime buxhetore, propozimet tona nuk janë marr parasysh në buxhet hiç. Ndërtimi i rrugëve në disa fshatra nuk specifikohet se sa rrugë, ose në cilat rrugë. Po ashtu te renovimi efiçinet i shkollave

nuk specifikohet se për cilat shkolla bëhet fjalë. Po ashtu për tregun ditor janë ndarë mjete për dy vite. A nuk janë ndarë mjete njëherë për ndërtimin e tregut të tregut të gjelbër? Ky buxhet, nuk ka ide të reja buxhet i njëjt si vitet e mëhershme, dhe ne nuk do ta votojmë si grup i LVV-së këtë buxhet.

Fitim Mëziu, tha se te buxheti, në tabelë është paraqitë investimi për urgjencën, në bazë të ligjit nuk lejohet të kemi urgjencë të veçantë. Unë kam një propozim që një objekt i ri të bëhet komplet për QKMF-në, ku të gjitha njësitë do të korporohen në të njëjtin objekt. Pasi që të ndërtohet një urgjencë duhet të ketë edhe specialistë të fushave të veçanta.

Lulzim Rrustemi, një buxhet i avancuar dhe kjo donë menaxhim të mirë. Një buxhet që shumica është nda në paga dhe mëditje subvencione, mallra dhe shërbime dhe shërbime komunale. Në vitin 2023 buxheti më i madh shkon në shërbime publike, shëndetësi, bujqësi. Në investime kapitale kemi një shumë të mirë. Ne arsim do të ishte mire të kaloj disa mjete nga administrata në mënyrë që të rritet numri i bursave për studentë. Te arsimi duhet të rriten subvencionet. Te zhvillimi ekonomike do të duhej të ketë buxhet më shumë, që ne mos me prit intervenime prej qeverisë. Në këtë buxhet ne vitin 2023, nuk kemi asnjë projekt të madh për ujësjellësit. Ndërtimi i sheshit për 3 vite, nuk e di a kemi projekt dhe plan rregullativ urban. Ndërtimi ditor, nuk e di sa do të mundem me aktualizua. Po ashtu do të duhet të jetë një memorial i përbashkët për të gjithë dëshmorët e komunës së Lipjanin. Te shëndetësia po mungon blerja e autoambulancave. Te stadiumet do të duhet që të kalojnë në bari natyral nga ai artificial. Ndërtimi i këndeve të leximit një propozim i mirë në bibliotekë. Një shkollë fillore duhet të jetë në Lipjan, pasi çdo ditë po rritet numri i banorëve në Lipjan.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha, unë kam dërguar shkresa në ministri dhe Ministria na e ka ndalu projektet që nuk janë pronë e jona. Dhe e drejta për ujë ka kaluar në KRU-Prishtina. Tani në njëjtin kod buxhetor do ta kemi edhe projektin edhe asfaltin edhe shpronësimin edhe mjetet. Neve nuk po na lejohet të investojmë në disa banesa po ashtu edhe në disa varreza, te të cilat nuk janë pronë e jona. Buxheti, nuk është rritë por zhvlerësua, se tani janë rrit çmimet. Subvencionet në Administratë janë për praktikantë të transferuara nga drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim. Tregu ditor është në buxhet dhe do te kryhet. Sa i përket lapidarëve do ta bëjmë një memorial për të gjithë dëshmorët e komunës sonë. Autoambulanca do të kalohet në mjetin për hemodializë. Por do ta shohim edhe për autoambulancë. Por ne kemi problem me numër të punëtorëve që nuk po na lejohet nga niveli qendror. Në Lipjan do të ketë një shkollë fillore të madhe.

Egzona Bytyqi, tha se te turizmi nuk e ka asnjë të hyrë nga resurset të cilat i kemi edhe pse e di që është e pa mundur me u përfshi ne buxhet te gjitha kërkesat. Sa i përket buxhetit, unë e përkrah çdo investim në shëndetësi, pasi do të jentë ne te mirën e të gjithë qytetarëve të komunës së Lipjanit.

Ganimete Qeriqi, tha se një autoambulancë në emergjencë është shumë e nevojshme dhe urgjente, ose nuk ka mundësi autoambulancë të paktën një veturë për bartje të pacientëve.

Arsim Jashari, tha se e përkrah ekzekutivin në këtë rast, dhe nëse qeveria e Kosovës i pengon gjërat është keq për komunën tonë.

Besiana Sylja, tha se unë e bëra një pyetje pse janë nda 60mijë euro për Administratë komunale?

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se çështja e turizmit më shumë menaxhohet nga niveli qendror, por do të shohim çka mund të bëjmë ne si komunë. Shkollat në Banullë dhe Dobrajë nuk janë përfshi, pasi që e kemi lënë mos po i kryejmë më herët nga Ministria . Pastaj tha se buxhetin propozoj ta votoni pa i prekur shifrat por duke i harmonizua emërtimet, me pas të drejtën ekzekutivi qe mos me ardh prapë në Kuvend

Meqë diskutime tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit me ndryshimet e cekura me lart, dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për,4 kundër 10abstenime, aprovoi Vendim

Pastaj dha Kryesuesi pauzë nga ora 12:20 deri në ora 14:00

V

Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit për monitorimin e zbatimit të Hartës Zonale të Komunës së Lipjanit për periudhën 3 Korrik 2021 – 3 Korrik 2022.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Imri Semetishtit ,DPUMM, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se në bazë të këtij raporti, po shihet se sektori i ndërtimit i cili ka qenë sektori me profitabil i cili ka ngec për shkak të një gabimi me rastin e miratimit të Hartave Zonale , pasi që nuk është marrë për bazë gjendja faktike. Ku shumica e kërkesave janë refuzuar nga sektori i urbanizmit. Na si grup e kemi ngrit

disa herë këtë çështje edhe pse nuk janë marrë parasysh. Tash në qendër të Lipjanit është vështirë të ndërtohet.

Imri Semetishti, tha se unë e kam prezantuar gjendjen reale, vështirësitë janë të theksuara por do të provojmë t'i harmonizojmë me planin zhvillimor urban. Edhe spe nuk do të jetë një proces i lehtë por ne do të provojmë të bëjmë diçka.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 16 vota për, 10 kundër 2 abstenime, aprovoi Raportin

VI

Propozim Vendim për miratimin e programit trevjeçar për banim 2022-2025 të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Shkelzen Hajdini , drejtor i DSHPS, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se unë edhe në KPF, ju kam përgëzuar për këtë propozim dhe ju kisha rekomanduar të gjithëve me lexuar, ajo që është shqetësuese është ndërtimi i këtij objekti. Ne si grup i PDK-së e përkrahim këtë propozim

Lulzim Rustemi, tha se sa banesa të lira i ka Lipjani për banim, kur dihet që na e kemi një pronë të ish-tregu i kafshëve që është folë që do të jetë pronë për banim për kategoritë e dala nga lufta.

Shkelzen Hajdini, deri tash janë nda 21 banesa, ndërsa janë edhe 10 banesa të lira.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 30 vota për, aprovoi Vendim.

VII

Propozim Vendim mbi caktimin e tarifave për qëndrimin ditor të fëmijëve në institucionet parashkollore në fshatrat Gadime dhe Sllovi.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Rasim Hasanit drejtor i DKA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Daut Azemi, kryesues i kuvendit tha se unë e kam pranuar një kërkesë nga grupi i LVV-së në kuvendit për amandementimin të këtij propozim vendimi, kur kërkoj nga propozuesit ta sqaroj këtë.

Alban Salihu, tha se na e kemi konsideruar se tarifat për qëndrim ditor të fëmijëve në shkolla i propozuar nga kryetari i komunës është diskriminues për qytetarët e komunës tonë dhe si i tillë duhet të plotësohet, sepse ky propozim vendim përjashton familjet e fëmijëve që i kanë regjistruar në çerdhen e qytetit . propozimi ynë është që të hyjë edhe çerdhja e qytetit.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se ne po flasim për të njëjtën shtëpi është në kuadër të së njëjtës çerdhe që menaxhohet nga komuna. Hapja e këtyre dy çerdheve është shumë pozitive pasi që kjo ndikon në mos shpërnguljen e banorëve nga fshatrat në qytet. Do të ishte mirë që të ketë një kriter për ata që i binë nxënësit nga fshati në qytet. Ne si grup i PDK-së e kemi një propozim që t'i lirojmë të gjithë nga pagesat deri në dhjetor, pastaj vijmë me një vendim tjetër.

Albiona Tasholli, tha se pasi që çerdhet në qytetin e Lipjanit janë të stër ngarkuara, çmimi nuk duhet të jetë i njëjtë si në fshat si në qytet, për shkak se prindërit që jetojnë në fshatra prap do t'i bijnë fëmijët në qytet. Propozoj që për fëmijët në fshatra të hiqet krejt pagesa nëse ka bazë ligjore.

Imri Ahmeti, kryetar i komunës tha se, është pozitive pasi që po hapen këto çerdhe të reja në Komunën tonë. E dyta jemi në fazën testuese , dhe ende nuk e dijmë sa fëmijë do t'i binë prindërit në këto çerdhe. Ne po mundohemi ta ndalim migrimin dhe nëse do të jetë çmimi i njëjtë si në qytet si në fshatra ,prindërit prap do ti binë fëmijët në qytet. Kostoja financiare ende nuk dihet, pasi nuk e dijmë numrin nxënësve. Duhet të jemi krenar që po ndërtohen çerdhe.Fëmijët që janë në çerdhe të qytetit ,99% të tyre i kanë të dy prindit e punësuar .

Arsim Jashari, tha se i rekomandoj që fëmijët në fshatra mos me ardhe me u regjistruar në çerdhe në Lipjan. Dhe propozimi im ke që fëmijët në çerdhe me u liruar deri në dhjetor.

Alban Salihu, tha se se organet komunale kane mekanizma qysh me e zvogëluar pabarazinë, e dyta pasi prindërit po i bijnë fëmijët në qytet i bie që në fshatra mësimi është duke u bërë dobët. Na i propozojmë që të zvogëlohet çmimi te çerdhja edhe në qytet

Imri Ahmeti, tha se vendimi që e kam marrë për çerdhe është i ligjshëm dhe nëse mendon që është i paligjshëm ka organe të cilat merren me këtë punë dhe dërgoje.

Nexhmedin Lekiqi, tha se ideja e kryetarit në fshat për çerdhe është ide shumë e mirë, veç po ja kam frikën që mos po fillojnë prindërit nga Lipjani t'i bijnë fëmijët në çerdhe në Gadime.

Alban Salihu, tha se kërkoj nga kryetari i kuvendit ta menaxhosh seancën e Kuvendit, shfrytëzoje autoritetin sonë edhe vepro njëjtë ndaj të gjithëve.

Daut Azemi, kryesues i Kuvendit tha se nuk është mirë me fol nga vendi, por duhet me kërkuar fjalën dhe me dal në foltore me folë, nëse nuk e respektoni rregulloren e punës unë ua ndërpres fjalën secilin që nuk e respekton rregulloren.

Lumturije Bytyqi-Hasani, tha se ne si Kuvendi kemi qenë shembull për kulturë, por duhet me u ndal gjuha ofenduese në Kuvend nga të dy palët. Ne i kemi dy propozime në Kuvend , një nga ekzekutivi, ndërsa tjetra nga LVV-ja, është mirë të shikohet tarifa në mbledhjen e ardhshme dhe të dilet me një vendim.

Imri Ahmeti, unë mbës pranë propozimit të ekzekutivit dhe kërkoj nga ana juaj që ta votoni.

Lulzim Rrustemi, do të ishte mirë që këto tarifa me qenë deri në 31 dhjetor të vitit 2022, ndërsa në vitin 2023 me pas vendim tjetër.

Rasim Hasani, tha se çerdhet janë ta gatshme, por skanë filluar të punojnë për shkak të grevës, dhe do të jemi në fazën testuese.

Arsim Jashari, tha se, ligji për arsim para fillore ka me hy në fuqi, dhe ne jemi që këto tarifa prapë të shikohen në janar.

Daut Azemi, tha se së pari po e qes në votim kërkesën për amandementim nga LVV-Ja.

Pas votimit konstatoi se Kuvendi me 5 vota për, 16 kundër dhe 10 abstenime nuk kaloi amendamenti i propozuar.

Pastaj Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 17 vota për, 10 kundër dhe 3 abstenime e aprovoi Vendimin.

Propozim Vendim për formimin e komisionit përzgjedhës për përzgjedhjen e drejtorëve dhe zëvendësdrejtorëve në institucionet publike edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Rasim Hasanit drejtor i DKA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Alban Salihu, tha se ligji thotë se komisioni përbehet nga 3 anëtarë, i pari duhet të jetë nga DKA-ja, i dyti ekspert i pavarur i Arsimit, drejtori i institucionit me performancë të lartë, përfaqësues i prindërve në nivel komune, ligji i ofron 3 mundësi, ndërsa kryetari i komunës e zgjedh vetëm një. Ne si grup nuk do të marrim pjesë në këtë votim.

Arsim Jashari, tha se, është mirë të bëhet deplizimi dhe të merret një ekspert i jashtëm, siç po e bëjnë disa komuna tjera.

Rasim Hasni, tha emrat se janë propozuar, në bazë të ligjit.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 15 vota për, 7 kundër 2 abstenime, aprovoi Vendim

IX

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi – KKSB-së.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 26 vota për, aprovoi Vendim

XI

Propozim Vendim për përcaktimin e kompensimit të anëtarëve të komisionit komunal të aksionarëve në ndërmarrjen publike lokale "Pastrimi".

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, aprovoi Vendim

XII

Propozim Vendim për përcaktimin e destinimit dhe ndryshimin e titullarit të paluajtshmërisë nga shkolla fillore Banullë në Komunë e Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, Rasim Hasanit drejtor i DKA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Arsim Jashari, tha se a do të ndryshohet titullari vetëm 50 ari, apo i gjithë komplet.

Daut Azemi, do të ndryshohet komplet e gjitha.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 20 vota për, aprovoi Vendim

X

Raporti gjashtëmuor, Janar-Qershor 2022, i punës së Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorateve Komunale.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën, kryetarit të komunës Imri Ahmeti, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga raporti

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Besiana Sylja, tha se te lëndët e ish Kosova-Transit, është një obligim i komunës e ku këto lëndë edhe ngarkojnë buxhetin e komunës. Çka do të ndërmarrë komuna që të mos rrezikohen investimet kapitale?

Egzona Bytyqi, tha se do të ndalem te shëndetësia, është një raport i mirë por kam pritë që te shëndetësia do të kemi një raport më të detajuar, pasi do të ishte mire

te dihet edhe numri i vizitave në të gjitha QMF-të dhe AMF-të, me pa lloji i shërbimeve të cilat janë ofruar. Tjetra, te flitet edhe për punët dhe progresin që ka arritë urgjencave, sa dhe sa ka qenë numri i atyre që kanë kërkuar ndihmë në urgjencë. Te sektori i analizave, sa është numri i atyre që kanë bërë analiza. Cilat analiza janë shtuar? Po ashtu për barnatoren e qytetit si është gjendja. Shërbimet në sektorin e vaksinimit sa janë? Sa është numri i vizitave stomatologjike?

Lulzim Rrustemi, tha se është obligim i komisioneve të kuvendit me pas nga nja takim dhe me pasqyrë gjendjen reale dhe me pasqyruar nganjëherë para Kuvendit, s e çfarë punë kanë bërë, dhe të përshkruhet në raport

XIII

Propozim Vendim për ndarjen e mjeteve financiare për trajtimin qenve endacak në territorin e Komunës së Lipjanit.

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i'a dha fjalën, Rexhep Rexhepit, drejtor i DBPZHR, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj kryesuesi e hapi diskutimin?

Fadil Spahiu, tha se çka do të bëhet me këto mjete, a është bërë ndonjë planifikim?

Alban Salihu, tha se në kuvend disa herë e kemi ngritë çështjen e qenve endacak është një hap pozitiv, por nuk ka një plan se për çka kanë me u përdor këto mjete?

Rexhep Rexhepi, tha se vlera prej 10 mijë euro është e vogël por në bazë të specifikave që na i ka caktuar niveli qendror këtë shumë na i kanë caktuar për fillim por në vitet në vazhdim do të vazhdojmë me shumat tjera.

Meqë diskutime nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozimin e vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 23 vota për, 3 abstenime, aprovoi Vendim.

XIV

Propozim Vendim për zëvendësimin e anëtarët të komitetit për shëndetësi dhe përkujdesje sociale

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi.

Pastaj tha se ka një reagim nga Dr. Fitim Mëziu për këtë?

Fitim Mëziu tha se, para disa kohe kam dhënë tërheqje me qëllim që të vij dikush që do të jep kontribut në shëndetësinë e Lipjanit, por do të mbetet në dorën e anëtarëve të Kuvendit si do të vendosin?

Alban Salihu, tha se ka qenë kërkesë e kamotshme e Fitim Mëziut, për tërheqje, ndërsa në muajin gusht e kemi pas kërkesën edhe me shkrim, por si duket paska ndërruar qëndrim, dhe ne me pas ditë nuk e kishim prurje në kuvend, nëse ai e ka ndryshuar mendimin në tërheqim këtë pikë nga rendi i ditës

Pastaj Kryesuesi tha se duhet të votojmë për tërheqje nga Kuvendi të kësaj pike?

Pastaj, Kryesuesi vuri në votim propozimin për tërheqje të vendimit dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 27 vota për, votoi për tërheqje të Vendimit.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbledhja përfundoi në ora 15,15

Ekstraktin e hartoi

Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi